



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/
Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVO CADASTRAL AGENCY



Rëndësia e Informacionit Gjeohapësinorë:

Strategjia për Zhvillimin e Infrastrukturës
Kombëtare për Informacion Hapësinorë të
Republikës së Kosovës

Qershor 2015

Rëndësia e Informacionit Gjeohapësinorë: Strategjia për Zhvillimin e Infrastrukturës Kombëtare për Informacion Hapësinorë të Republikës së Kosovës

Dokumenti: 1.0

Shpërndarja

Agjencisë Kadastrale të Kosovës

Grupit të Palëve të Interesit të IKIH-së

Ministrive dhe Zyrtarëve të Qeverisë të Republikës të Kosovës

Ekipit të Strategjisë të IKIH-së

KU Leuven

Historiku i versionit

<u>Versioni</u>	<u>Data</u>	<u>Autori/autorët</u>	<u>Vërejtje</u>
0.1	10 Prill 2015	Joep Crompvoets	Drafti i parë
0.2	19 Prill	Joep Crompvoets	Drafti i dytë
0.3	30 Prill	Joep Crompvoets	Drafti i tretë
0.4	28 Maj	Joep Crompvoets	Drafti i katërt
1.0	19 Qershor	Joep Crompvoets	Verzioni i parë

Rishikimi i Historikut

<u>Versioni</u>	<u>Data</u>	<u>Autori/ autorët</u>	<u>Vërejtje</u>
0.1	17 Prill 2015	Muzafer Çaka Denis Pitarka	Drafti i parë
0.3	25 Maj 2015	Kathrine Kelms Zdravko Galic Bujar Nushi	Drafti i tretë

Agjencia Kadastrale e Kosovës

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë

Nr. i telefonit: 038 512 353

Email: akk@rks-gov.net

Financuar nga Banka Botërore

E drejta e autorit

Qershor 2015

PËRMBAJTJA

Parathënie	4
Përmbledhje Ekzekutive.....	5
Rëndësia e Informacionit Gjeohapësinorë: Strategjia për Zhvillimin e Infrastrukturës Kombëtare për Informacion Hapësinorë të Kosovës.....	6

Shtojcat

1. Historiku për krijimin e Strategjisë për Infrastrukturën Kombëtare për Informacion Hapësinorë të Kosovës
2. Zhvillimi i Strategjisë për Infrastrukturën Kombëtare për Informacion Hapësinorë të Kosovës si dhe lista e palëve të interesit të konsultuara.
3. Përmbledhje e ndryshimeve operacionale që do të lehtësohen me zbatimin e Strategjisë për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinorë të Kosovës.
4. Temat e Direktivës të BE-së INSPIRE dhe referencat thelbësore gjeografike
5. Struktura qeveritare e propozuar për Strategjinë mbi Zhvillimin e infrastrukturës Kombëtare për Informacion Hapësinorë të Kosovës
6. IKIH- Vlerësimet e kostos për Implementim
7. Lista e shkurtesave
8. Fjalori i termave

PARATHËNIE

Pothuajse çdo herë, njerëzit duhet të dinë kur dhe ku ndodhin gjërat: informacioni gjeohapësinorë është i rëndësishëm.

Në vitin 2013, unë kam kërkuar nga Banka Botërore që të financojë Strategjinë për zhvillimin e Infrastrukturës Kombëtare për Informacion Hapësinorë të Republikës së Kosovës.

Ky është raporti rezultues. Ishte pranuar nga Ekipi i Strategjisë për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinorë si instruksion i rrugëtimit për informacion gjeohapësinorë në Republikën e Kosovës.

Strategjia për Zhvillimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinorë (IKIH) është një dokument i menduar mirë, autoritar dhe i rëndësishëm dhe rekomandimet e tij janë të lidhura ngushtë me ofrimin e politikës së qeverisë në shumë fusha. Të njëjtat mendime i ndajnë me mua edhe disa kolegë të ministrisë lidhur me njohjen e realitetit, të identifikuar nga Strategjia që 'çdo gjë ndodh diku'.

Qeveria e pranon se të kuptuarit e informacionit gjeohapësinorë është një faktor i rëndësishëm për të çuar përpara agjendën transformuese të qeverisë. Zbatimi i kësaj Strategjie do ta bëjë informacionin gjeohapësinorë relevant, të harmonizuar dhe cilësorë në dispozicion me qëllim të formulimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit për krijimit të politikave në një gamë të gjerë të sektorëve si dhe për qytetarin për të pasur qasje në informacion gjeohapësinorë, qoftë lokal apo (ndër) kombëtar. Për më tepër, ajo do të shtojë vlerën në publik, qeveri dhe shoqëri tregtare në Republikën e Kosovës në përdorimin e informacionit gjeohapësinorë si dhe do të ofrojë një kornizë të qëndrueshme për të ndihmuar iniciativat kombëtare dhe lokale, dhe të ofrimin të shërbimit për të mirën e të gjithë popullit tonë.

Fushat kryesore ku Strategjia e IKIH-së do të përfitojë janë fushat e politikave dhe zonat operative të sektorit publik dhe privat, ku shkëmbimi dhe integrimi i informacionit gjeohapësinorë është thelbësorë për vendimmarrje. Gjithashtu do të jetë bazë për përmbushjen e detyrimeve sipas një Ligji të sapoformuar mbi themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës dhe Direktivës së BE-së INSPIRE (2007/2 / KE).

Hapat e rëndësishëm janë:

- Të kërkojë komente për Strategjinë dhe se si do të ecë përpara ;dhe
- Të sigurojë që janë bërë alokimet e duhura të financimit për të mbështetur zbatimin e tij.

Këshilli i IKIH-së do të vazhdojë me punën e tij të shkëlqyeshme të bërë nga Ekipi I Strategjisë të IKIH-së, i cili ekip tani do të shpërbëhet. Dëshirojë t'i falënderohem Ekipit të Strategjisë të IKIH-së të mbikëqyrur nga Prof. dr. Joep Crompvoets, për punën e tyre të konceptimit, zhvillimit dhe përkrahjes të Strategjisë së IKIH-së deri në këtë pikë.

Prof. Dr. Murat Meha

Kryeshef i Agjencisë Kadastrale të Kosovës- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Informacioni gjeohapësinorë është i rëndësishëm. Informacioni lidhur me hapësirën e lokacionit është me rëndësi. Çdo gjë ndodh diku. Nëse ne mund të kuptojmë më shumë për natyrën e një lokacioni në Tokë, ku ndodhin gjërat, si dhe ndikimet në njerëz dhe pasuritë në atë lokacion, atëherë ne do të mund të planifikojmë më mirë, ta menaxhojmë rrezikun më mirë dhe t'i përdorim më mirë burimet tona. Kjo do të rrisë normën e suksesit për iniciativë të reja, të ndihmojë në uljen e potencialit për problemet e ardhshme dhe të japë përfitime financiare të prekshme.

Aktualisht, shumë datase (sete të informacionit) gjeohapësinore në pronësi të qeverisë mund të grumbullohen lehtësisht dhe analizohen me besueshmëri nga të gjitha organet qeveritare (kombëtare) lokale dhe qendrore. Aty gjenden shumë dyfishime, shumë pak ri-përdorim dhe shumë pak lidhje nëpër datase të cilat janë të nevojshme për të mbështetur zbatimin e politikave si për shembull në: planifikimin, strehim, përjashtimi social dhe menaxhimin të trafikut.

Qëllimi i zhvillimit të Strategjisë për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinorë të Kosovës është që të bëjë informacionin gjeohapësinorë relevant, të harmonizuar dhe cilësorë me qëllim të formulimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të bërjes së politikave në një gamë të gjerë të sektorëve si dhe që për qytetarët që të kenë qasje në informacion gjeohapësinorë, qoftë lokal apo (ndër) kombëtar. Për më tepër, Strategjia gjithashtu synon të kontribuojë për të maksimizuar vlerën në publik, qeveri dhe biznese të informacionit ekzistues gjeohapësinorë. Kjo Strategji do të ofrojë një kornizë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për të ndihmuar iniciativat kombëtare dhe lokale dhe për të ofruar shërbime.

Fushat kyçe ku Strategjia do të përfitojë janë kryesisht në politika dhe zonat operative të sektorit publik ku informacionet gjeohapësinorë të shkëmbyera dhe të integruara janë të vlefshme për vendimmarrje. Këto përfshijnë ndër të tjera planifikimin (Hapësinorë) për komunitete, mjedis, shëndetësi, edukim, siguri, ndërtim, miniera, transport, parandalim të krimit, sigurim, tregti me pakicë, energji, ndryshim të klimës, bujqësi, trashëgimi kulturore, turizëm, sport, punësim dhe statistika.

Strategjia do të dorëzohet në bashkëpunim me qeverinë qendrore (kombëtare) dhe lokale në Republikën e Kosovës. Ajo do të përqendrohet në bashkimin dhe integrimin e informacioneve nga burime të shumta brenda një kornize të qëndrueshme referimi, duke çuar në procese më efektive ndër-organizative, për shpërndarje më të madhe dhe ri-përdorim në të gjithë sektorin publik dhe më gjerë.

Ekipi i Strategjisë së IKIH-së është konsultuar gjerësisht (shih listën e palëve të interesit në shtojcën 2), dhe ka rënë dakord me rekomandimet dhe veprimet e nevojshme për të ofruar këtë Strategji.

Anëtarët e Ekipit të Strategjisë së IKIH-së kanë rekomanduar këtë Strategji dhe veprimet e përcaktuara në të. Ata besojnë se kostot e zbatimit janë tejkuluar nga përfitimet që fillojnë dhënie thelbësore në tre vitet e ardhshme. Strategjia për zhvillimin e infrastrukturës Kombëtare për Informacion Hapësinorë është parë që të jetë në interes të vendit dhe esenciale për të siguruar vlera maksimale nga burimet, të cilat do të duhet të shpenzohen në çdo rast për zbatimin efektiv të (draft) "Ligjit për Krijimi i një Infrastrukture për Informacion Hapësinorë në Kosovë" dhe Direktivën BE INSPIRE.

Për informata të më gjerësisht, vizitoni: <http://www.kca-ks.org/>

RËNDËSIA E INFORMACIONIT GJEOPAPËSINORË: STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN E INFRASTRUKTURËS PËR INFORMACION HAPËSINORË TË KOSOVËS

Hyrje

Shumica e informacionit e grumbulluar nga sektori publik përmbanë informacion gjeohapësinorë apo informacion të bazuar në vendndodhje. Me rastin e krahasimit apo lidhshmërisë të llojeve të ndryshme të informacionit me njëri-tjetrin, të kuptuarit mund të rritet në mënyrë të konsiderueshme, dhe në këtë mënyrë mund të merren vendime efektive për një vend të veçantë në Tokë.

Për qytetarin, informacioni gjeohapësinorë efektiv, i kombinuar me informacione të tjera, mundëson ofrimin e shërbimeve emergjente në mënyrë të shpejtë në vendin e duhur, njohurinë se ku gjenden shërbimet lokale, shmangien e bllokimeve të komunikacionit dhe menaxhimin më të mirë të jetës së njeriut si rezultat i qasjes në më shumë informacione.

Për komunitete, informacioni gjeohapësinorë lehtëson financimin e barabartë për rigjenerim dhe mundëson zgjidhje për probleme të tilla siç janë privimi, krimi dhe çrregullimi që do të trajtohen në mënyrë efektive dhe të bashkuar.

Për qeverinë lokale, informacioni gjeohapësinorë mbështet partneritete, ndihmon atë për të ofruar shërbime më të mira dhe më efektive publike, dhe krijon efikasitet duke ndihmuar caktimin e burimeve të duhura në vendet e duhura; kjo i ndihmon qytetarët që të jenë më të pavarur.

Për qeverinë qendrore (kombëtare) informacioni gjeohapësinorë mbështet formulimin dhe vlerësimin e politikave efektive; është thelbësorë për të mbështetur qasjen ndaj ndryshimeve klimatike, menaxhimin e emergjencave në tërë Kosovën siç mund të jetë një shpërthim i një sëmundje të kafshëve apo përmytjet, dhe gjithashtu ofron mbështetje kritike për shërbimet e sigurisë.

Në korrik të vitit 2013, Agjencia Kadastrale e Kosovës me mbështetjen financiare të Bankës Botërore hapi një tender për zhvillimin e Strategjisë të Infrastrukturës Kombëtare për Informacion Gjeohapësinorë të Republikës të Kosovës si një iniciativë për lehtësimin e qasjes, ndarjes, dhe përdorimit të informacionit gjeohapësinorë (Meha et al., 2014). Historiku i të menduarit prapa krijimit të Strategjisë së bashku me detajet e anëtarëve të Ekipit të Strategjisë së IKIH-së është radhitur në Shtojcat 1 dhe 2.

Qëllimi i zhvillimit të Strategjisë për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinorë të Kosovës është që të bëjë informacionin gjeohapësinorë relevant, të harmonizuar dhe cilësorë me qëllim të formulimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të bërjes së politikave në një gamë të gjerë të sektorëve si dhe për qytetarët që të kenë qasje në informacion gjeohapësinorë, qoftë lokal apo (ndër) kombëtarë. Për më tepër, Strategjia gjithashtu synon të kontribuojë për të maksimizuar shfrytëzimin dhe përfitimet e publikut, qeverisë dhe bizneseve nga informacioni gjeohapësinorë si dhe të ofrojë një kornizë pune për të ndihmuar iniciativat kombëtare dhe lokale. Zbatimi i Strategjisë nëpër Kosovë do të ndërtojë një infrastrukturë koherente të informimit të orientuar në Teknologji Informative të Komunikimit (TIK) për informacion gjeohapësinorë, e cila do të ndihmojë politikën, ofrimin e shërbimeve lokale dhe vendim -marrjen operationale. Kjo do të largojë shpenzimet në mbledhjen e të dhënave, do të shtojë ri-përdorimin e të dhënave dhe efikasitetin duke përmirësuar përmbushjen e politikave si dhe dërgesave operationale, e cila do të zvogëlojë kostot e zbatimit. Do të jetë një bashkëpunim i qeverisë qendrore dhe lokale në Republikën e Kosovës.

Pse është i rëndësishëm informacioni gjeohapësinorë?

Pyetja 'ku?' shtrohet vazhdimisht, për shembull

- Ku duhet ta ndërtojë shkollën e re e cila i bashkon tre të tjera ekzistuese?
- Ku është qendra më e afërt e riciklimit apo pika e shitjes?
- Ku mund të ndodhë përmbytja?
- Ku duhet të ndërtohet qendra e re e rehabilitimit për përdoruesit e drogës?
- Ku do të shkaktojë problem ndotja e ajrit?
- Ku ndodhen lagjet të cilat kanë nevojë për fonde shtesë të regjenerimit?


Edhe pse për disa nga këto pyetje "ku" mund të gjendet përgjigjja shumë lehtë, shumë prej tyre janë më komplekse për t'u përgjigjur dhe kërkojnë bashkimin e disa grupeve të informacionit nga burime të ndryshme për të mbështetur procesin e vendimmarrjes; kjo ndodh me rastin e funksionimit të strategjisë. Për shembull, procesi i konsolidimit të shkollës kërkon të paktën:

- vendndodhjen e shkollave
- adresat e shtëpive të nxënësve ekzistues
- informacionin e censusit për të parashikuar nivelet e ardhshme të moshës së fëmijëve shkollorë në atë zonë
- disponueshmëria e tokës së përshtatshme
- kohën e udhëtimit dhe distancën nga shkolla.

Asimilimi i këtyre informacioneve të ndryshme dhe krijimi i disa 'çfarë nëse?' skenarëve është bërë shumë më i lehtë duke i integruar të gjitha burimet brenda në një kornizë të qëndrueshme referimi. Në këtë rast informacioni gjeohapësinorë dhe mjetet e analizimit shtojnë vlerë të konsiderueshme duke siguruar dimensionin Hapësinorë për të mbështetur vendimmarrjen.

Pse na duhet Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Hapësinorë?

Nga IKIH-ja përfiton kombi duke pasur një kornizë për lehtësimin e qasjes, shkëmbimit dhe përdorimit të informacionit gjeohapësinorë (Masser dhe Cromptoets, 2015). Korniza e tillë shërben për ta bërë informacionin relevant, të harmonizuar dhe cilësorë gjeohapësinorë në dispozicion me qëllim të formulimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të bërjes së politikave në një gamë të gjerë të sektorëve si dhe që qytetarët të kenë qasje në informacion gjeohapësinorë, dhe për të maksimizuar vlerën e informatës gjeohapësinore ekzistuese për publikun, qeverinë dhe kompanitë komerciale. Figura më poshtë paraqet parimet kryesore që duhet përmbushur IKH-ja (pjesërisht e nxjerrë nga Ministria Daneze e Ambientit, 2011).



Deklarata e Vizionit

“IKIH-ja e Kosovës do ta bëjë informacionin gjeohapësinorë të harmonizuar dhe me standard të lartë të gatshëm për formulim, zbatim, monitorim dhe vlerësim të politikave si dhe që qytetarët që të kenë qasje në informata Hapësinore qoftë lokale, kombëtare apo ndërkombëtare dhe për të maksimizuar vlerën e informacionit gjeohapësinorë ekzistues për publikun, qeverinë dhe kompanitë komerciale”.

D1.2 Deklarata e Misionit

“Për të themeluar kornizën administrative, institucionale dhe ligjore për bashkëpunim ndër-organizativ që do të:

- *Jetë në linjë me Direktivën INSPIRE*
- *Përkrah E-Qeverisjen dhe Institucionalizimin*
- *Integrojë informatat gjeohapësinore nga burime të ndryshme në një infrastrukturë.*
- *Shmang grumbullimin e dyfish të të dhënave gjeohapësinore*
- *Themelon një proces efektiv të biznesit*
- *Përmbush nevojat e palëve të interesit*
- *Promovon çasjen, ndarjen, përdorimin dhe shpërndarjen e të dhënave gjeohapësinore*

Pse na duhet Strategjia për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinorë të Republikës së Kosovës?

Përdoruesit aktualë të informacionit gjeohapësinorë shpenzojnë rreth 80 për qind të kohës së tyre për sistemimin dhe menaxhimin e informacionit dhe vetëm 20 për qind analizohen për të zgjidhur problemet dhe për të gjeneruar përfitime (Longhorn dhe Blakemore, 2008). Ky mosbalancim duhet të adresohet. Pjesa më e madhe e informacionit të grumbulluar nuk është në dispozicion për t'u përdorur përsëri pasi që nuk dihet gjerësisht se ishin grumbulluar dhe nuk dihet se ku janë ruajtur. Ka mundësi që të dhënat janë grumbulluar duke përdorur rregullat lokale të cilat parandajjnë përdorimin e tij me të dhëna rreth të njëjtin vend nga një organizatë tjetër. Ato gjithashtu mund të jenë grumbulluar në një format të veçantë të të dhënave që nuk janë përdorur në mënyrë universale dhe cilësia e grumbullimit mund të jetë e pa njohur.

Situata aktuale:

- paraqet kosto dhe jo efikasitet në një gamë të gjerë të organeve të sektorit publik për shkak të përpjekjeve të grumbullimit të të dhënave të ngjashme si dhe shkakton vështirësi në shkëmbimin e informacionit
- pengon përdorimin dhe integrimin e informacionit të saktë gjeohapësinorë për të informuar zhvillimin e politikave dhe shpërndarjen e drejtë të burimeve
- pengon strategjitë qeveritare për përmirësimin e shërbimeve për qytetarin
- paraqet vështirësi për qytetarët të kuptojnë se ku mund të merren të dhënat për aplikimet e komunitetit që inkurajojnë kontributet lokale të informatës në dispozicion, p.sh. ueb aplikacioni i një komuniteti i kombinuar me të dhëna të ndryshme për të ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve lokale.

Është shumë e qartë që në Republikën e Kosovës:

- Momentalisht ka pak njohuri rreth grumbullimit të të dhënave, ruajtjes së tyre apo mbajtjes nga sektori publik apo sektori privat.

- Përveç kësaj, dihet se në kuadër të Republikës së Kosovës ka shumë pak standarde të të dhënave që përdoren në mënyrë universale për referenca dhe për grumbullimin e të dhënave gjeohapësinore të përshkruara nga qeveria apo nga sektori privat

Për më tepër, shumica e të dhënave në qeveri ka dy attribute kryesore:

- Për kë është? – identitetin e individëve dhe kompanive
- Për ku bëhet fjalë? – vendndodhjen e komuniteteve, pasurive, aktiviteteve apo kushtet mjedisore.

Rëndësia e menaxhimit të identitetit tanimë është e njohur- si dhe Qeveria ka një program për të krijuar një infrastrukturë kombëtare për çështjet e identitetit. Megjithatë, deri tani rëndësia e informacionit gjeohapësinorë nuk ka qenë e njohur gjerësisht (Nushi et al., 2012). Strategjia për Zhvillimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinorë plotëson fokusin i cili është 'kush' duke shtuar një fokus të veçantë paralel 'ku'. Për shumë fusha të politikave dhe të dhënies së shërbimeve duhet pasur informacion të mirëfilltë për të dyja.

Gjatë zhvillimit të Strategjisë është kuptuar se mbi 80 për qind e të gjithë informacionit të sektorit publik kanë një element gjeohapësinorë, për shembull:

- një adresë
- një kod postal
- një lagje
- një sipërfaqe të regjistruar me të dhëna
- një koordinatë të hartës
- një kufi politik apo struktural.

Për më tepër, disa raporte janë publikuar duke përfshirë të dhënat gjeohapësinore gjatë disa viteve të fundit; ku është demonstruar rëndësia e informacionit gjeohapësinorë:

- informacioni i sektorit publik është një aset i madh i pashfrytëzuar me një vlerë prej 40 miliardë Eurosh për Bashkimin Evropian (Vikery, 2011)
- sektori gjeohapësinorë gjeneron ndërmjet \$150 miliardë dhe \$ 270 miliard në të ardhura në nivel global çdo vit (Oxera, 2013)
- zbatimi i Strategjisë në Mbretërinë e Bashkuar £ 70 - £ 130 milion përfitime për aktivitete të mbrojtjes së mjedisit në Mbretërinë e Bashkuar dhe £ 470 - £ 510 milion përfitime për departamentet qeveritare të Mbretërisë së Bashkuar.

Ndikim tjetër në zhvillimin e Strategjisë kishte publikimi i Direktivës INSPIRE i Bashkimit Evropian (BE-së) (Infrastruktura për Informacion Hapësinorë në Evropë), e cili me 15 maj 2007 u bë ligj Evropian. Direktiva INSPIRE përcakton kërkesat e përgjithshme për të krijuar një infrastrukturë për Informacion Hapësinorë në Evropë për qëllime të politikave mjedisore të BE-së, politikave dhe aktiviteteve të cilat mund të kenë ndikim në mjedis, duke përdorur të dhënat gjeohapësinore të mbajtura nga autoritetet publike. Anëtarëve të Bashkimit Evropian i 'u është dashur të zhvendosin Direktivën (të sjellin në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative për t'u përputhur me Direktivën) brenda dy viteve të asaj date (d.m.th. me 15 maj 2009). Përveç kësaj, Rregullat e Zbatimit, kryesisht aspektet teknike të Direktivës, duhej të zbatoheshin drejtpërdrejt si vendimet ashtu edhe rregulloret, përmes procedurës Komitologji (Masser dhe Cromptoets, 2015). Draft versioni i Ligjit të Kosovës 'Ligjit mbi Themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës është i lidhur ngushtë me Direktivën INSPIRE.

Megjithatë, Strategjia për zhvillimin e Infrastrukturës Kombëtare për Informacion Hapësinorë në Kosovë duhet të shkojë përtej fushëveprimit të vetë INSPIRE. Nevojat lokale dhe kombëtare në

kuadër të Republikës së Kosovës kërkojnë më shumë mbështetje në mënyrë të konsiderueshme. Për më tepër për të mbështetur iniciativat individuale 'gjeohapësinore', duhet mbështetur marrëveshjet legjislative për:

- menaxhimin e trafikut
- fshatrat dhe të drejtat e rrugës
- regjistrimin e tokës
- vlerësimin e pronës
- kontingjentet civile
- mbrojtjen e tokës

dhe për të mbështetur kërkesat e shërbimit publik që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e njerëzve, për shembull:

- nevojat për planifikimin dhe përdorimin e tokës
- programet e përjashtimeve sociale
- grumbullimin e mbeturinave
- monitorimin e ndikimit të ndryshimeve klimatike.

Të gjitha këto përmbajnë komponente gjeohapësinore dhe nevoja për të ndarë informacionin në nivelin lokal dhe vendor është tejet më e gjerë se që janë politikat mjedisore, të cilat janë të mbuluara nga INSPIRE.

Rezultatet e Strategjisë për infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinorë të Republikës së Kosovës

Zbatimi i Strategjisë për IKIH-në do të përqendrohet në bashkimin dhe integrimin e informacionit nga shumë burime publike brenda një kornize të qëndrueshme referimi e cila shpjen për një ndarje më të madhen të informacionit dhe përdorim në tërë sektorin publik dhe më gjerë. Do të ndërtojë një infrastrukturë koherente të informimit të orientuar në Teknologji Informative të Komunikimit (TIK) për informacion gjeohapësinorë, i cila do të ndihmojë politikën dhe vendim -marrjen operacionale. Kjo do të largojë shpenzimet për grumbullimin e të dhënave, do shtojë ri-përdorimin e të dhënave dhe efikasitetin duke përmirësuar përmbushjen e politikave, dërgesave operacionale dhe lokale, e cila do të zvogëlojë kostot e zbatimit. Kjo do të rezultojë në informacione lidhur me tokën e Kosovës, ujërat dhe ajrin:

- përshtaten për qëllim
- të grumbulluara me standardet e pranuar botërisht
- të mirëmbajtura siç duhet dhe të përdorura shumë herë nga sektori publik, privat dhe nga qytetarët
- të referuara në një kornizë definitive të informacionit i cili mbështet kombinimin e tyre pa pengesa
- mundëson më mirë proceset ndër-organizative efektive të biznesit
- gjendet lehtë dhe përmban terme të qarta për përdorimin e tij
- i thjeshtë për të pasur qasje në të, dhe i lehtë për ta shkëmbyer dhe integruar
- kuptohet mjaftueshëm për të maksimizuar zbatimin e tij, dhe
- në linjë me Direktivën INSPIRE dhe Evropën.

Rezultatet për palët e interesit

Me zbatimin e Strategjisë të IKIH-së do të përfitojnë palët e interesit në tërë ekonominë:

Qytetarët do të përfitojnë përmes shërbimeve më të mira të ofruara. Do të jetë shumë më lehtë për t'u përgjigjur pyetjes 'ku' dhe kështu do ta kuptojnë pyetjen "pse"?

Spektori Publik/Qeveria – ofruesit e shërbimeve do të ndajnë informacionin përtej partneriteteve në ofrimin e shërbimeve të përbashkëta të cilat janë shënjestruar në mënyrë më efektive, p.sh. luftën kundër krimi, çrregullimit dhe planifikimin e emergjencës.

Spektori Publik/Qeveria – hartuesit e politikave do të kenë qasje në të gjitha informatat e duhura për të mbështetur zhvillimin e politikave të bazuara në dëshmi dhe monitorim. Politikat do të shënjestrohen më mirë duke ditur karakteristikat e pranuesit dhe të vendndodhjes, p.sh. përdorimi i tokës bujqësore të klasës së ultë për banim, vlerësimin e ndërtimit të rrugëve, etj.

Spektori Publik/Qeveria – furnizuesit e informacionit pritjet që të prodhojnë informacion gjeohapësinorë që është i qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet e pranuar duke lejuar bashkimin e informatave pa pengesa. Aranzhimet e duhura për licencim do të shtojnë përdorimin e informacionit të tyre. Informacioni do të grumbullohet një herë dhe do të përdoret shumë herë.

Spektori i tretë i përbërë nga organizatat jo-qeveritare dhe nga organizatat e tjera jo-fitimprurëse do të jenë në gjendje për partneritet më efikas dhe më efektiv në ofrimin e shërbimeve nëpërmjet të shkëmbimit të më shumë informacioneve.

Spektori privat do të jetë në gjendje të plotësojë sektorin publik në mënyrë më efektive në krijimin e informacionit gjeohapësinorë dhe shërbimeve që kanë të bëjnë me vlerën e shtuar duke përdorur kornizat definitive të informacionit dhe standardet. Informacioni gjeohapësinorë dhe shfrytëzimi i tyre është në rritje të shpejtë dhe është industri fitimprurëse (Oxera, 2013) - industria potenciale gjeohapësinore e Kosovës mund të fitojë nëse teknologjia është shfrytëzuar dhe menaxhuar si duhet.

Si dhe do të përfitojnë individët/qytetari përmes efikasitetit dhe efektivitetit më të madh të shërbimeve dhe të shpërndarjes. Zbatimi i Strategjisë së IKIH-së do të sjellë nivele edhe më të mëdha të përfitimeve drejtpërdrejt në ekonominë e përgjithshme, komunitetin e biznesit dhe sektorët akademik dhe vullnetarë.

E tërë kjo nënkupton se i tërë informacioni gjeohapësinorë mund të luajnë rol kryesorë në zbatimin e një sërë agjendave të politikës publike, brenda tri temave kryesore:

- 1) Nxitjen e efikasitetit të shtuar dhe angazhimin e shoqërisë duke nxitur përdorimin e informacionit gjeohapësinorë në qeveri
- 2) Mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit në Kosovë përmes njohurive gjeografike
- 3) Përkrahjen e zhvillimit ekonomik duke njohur peizazhin ekonomik të Kosovës përmes gjeografisë.

Veprimet strategjike

Të sigurojë që Republika e Kosovës e bënë informacionin gjeohapësinorë relevant, të harmonizuar dhe cilësorë me qëllim të formulimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të bërjes së politikave në një gamë të gjerë të sektorëve si dhe që qytetarët që të kenë qasje në informacion gjeohapësinorë,

dhe të shfrytëzojnë të gjitha vlerat e atij informacioni. Zhvillimi i Strategjisë së IKIH-së kërkon një program të veprimeve strategjike i cili siguron që:

- të dimë se çfarë të dhënash kemi për të shmangur dyfishimin e tyre
- referenca është përdorur për të dhënat e njëjta kështu që ne e dimë që ne po flasim për të njëjtat vende
- informacioni gjeohapësinorë të mund të ndahet lehtë me anë të një infrastrukture të përbashkët të standardeve, teknologjisë dhe marrëdhënieve të biznesit.
- aftësitë e duhura janë në dispozicion, si në mesin e profesionistëve gjeografikë ashtu edhe në mesin e grupeve të tjera profesionale që përdorin informacionin gjeohapësinorë ose mbështesin përdorimin e saj
- ekziston udhëheqja dhe qeverisja e fortë për të shkuar përmes ndryshimit, duke përfshirë zbatimin e INSPIRE dhe të (draft ligjit) 'Ligji për themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës ". (Në këtë kontekst, quhet Këshilli i IKIH-së).

Të kuptojmë se çfarë të dhënash kemi dhe t'i shmangemi dyfishimit

Strategjia e IKIH-së dëshiron të sigurojë që informacioni lidhur me tokën e Kosovës, ujërat, dhe ajrin është grumbulluar një herë dhe pastaj përdoret shumë herë në sektorin publik dhe privat.

Çdo organizatë e sektorit publik duhet të regjistrojë dhe të mbajë të përditësuara detajet e dataseve gjeohapësinore. Kjo duhet të bëhet për të gjitha datasetet me atributet gjeohapësinore, duke përfshirë por pa kufizime në tokë, mjedis, bujqësi, hidrografi, hartë, dhe informacion socio-ekonomik.

Çdo organizatë e sektorit publik duhet vërë në dispozicion publikisht detajet e dataseve të tyre gjeohapësinorë - edhe në qoftë se vetë datasetet nuk janë në dispozicion të publikut apo nuk janë pa pagesë. Këshilli i IKIH-së duhet të pajtohet dhe të publikojë kriteret për përjashtime, dhe për propozimet individuale për përjashtime duhet të kërkohet qartë miratim nga Këshilli i IKIH-së.

Këshilli i IKIH-së, mundësisht në konsultim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, duhet të bien dakord dhe të mbajnë kërkesat minimale dhe standardet e përbashkëta për detajet e tilla dhe për qasjen e publikut, kur është e përshtatshme në bazë të standardeve të njohura të hapura. Detajet e regjistruara duhet të përfshijnë informacion lidhur me mënyrën se si janë grumbulluar dhe kur janë grumbulluar datasetet, tolerancat e tij të saktësisë, formati i tij, dhe të drejta e qasjes. Këshilli i IKIH-së duhet të monitorojë nga afër zbatimin dhe t'i raportojë qeverisë.

Këshilli i IKIH-së duhet të konsiderojë se si mund të arrihet më mirë botërisht një informacion i tillë. Ai duhet të marrë parasysh rastin, fushëveprimin dhe mundësitë e ofrimit të portaleve të zakonshme, shpërndarësve apo depove. Fushëveprimi për shqyrtim duhet bazohet në një vargë të gjerë të kërkesave, dhe jo vetëm në zbatimin e INSPIRE (ose në 'Ligjin për themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë ") në Republikën e Kosovës.

Popullimi i përmbajtjes së informacionit të cilat janë të qasshme në mënyrë qendrore do të jetë kërkesë e detyrueshme për sektorin publik. Mirëpo, do të ishte e pavend nëse qeveria kërkon nga organizatat e sektorit privat të aplikojnë këto kërkesa. Megjithatë, për organizatat e sektorit privat mundësia duhet të jetë e hapur për t'i aplikuar standardet dhe futur detajet e dataseve të tyre në një depo qendrore, nëse është zhvilluar. Në veçanti, Këshilli i IKIH-së duhet të angazhohet me grupet bashkëpunuese për të inkurajuar dhe lehtësuar zbatimin e këtyre standardeve.

Këshilli i IKIH-së në konsultim me mbajtësit e të dhënave të sektorit publik dhe me palët e tjera të interesit duhet të përcaktojë një periudhë kohore për implementimin e këtyre rekomandimeve, duke përfshirë përgatitjen dhe grumbullimin e metadatave në linjë me kërkesat e INSPIRE Rregullave të Zbatimit të Metadatave. Ky afat kohorë duhet të publikohet më së largu gjysmë viti pasi të miratohet kjo Strategji nga Qeveria.

Secili departament dhe organ i sektorit publik duhet të sigurojë që strategjia e tij e SI/ TI si dhe programi i punës përshkruan qartë politikat dhe planet e implementimit të sistemeve të të dhënave gjeohapësinore.

Këshilli i IKIH-së duhet të dakordohet, mundësisht me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, për të lejuar kohë për t'u marrë me projekte që përfshijnë të dhënat gjeohapësinore. Qëllimi do të jetë të shihet nëse ka dyfishime në krijimin e informacionit gjeohapësinorë, përdorim të të dhënave të cilat nuk përputhen me standardet e Këshillit të IKIH-së apo krijim të të dhënave gjeohapësinore në të cilat të dhëna nuk planifikohet të ketë qasje publiku.

Të dhënat referente të përbashkëta gjeohapësinore

Shkëmbimi efikas dhe me kosto efektive të informacionit me atributet gjeohapësinore në të gjithë sektorin publik dhe privat kërkon përdorimin e dataseve të përbashkëta të të dhënave themelore gjeohapësinore. Në veçanti, ekziston një numër i vogël itributeve gjeohapësinore të cilat janë përdorur gjerësisht në datasetet e organizatave, kështu që standardizimin e tyre do të jetë një përmirësim i madh në shkëmbimin e të dhënave në mes të organizatave.

Një numër i vogël i dataseve kryesore duhet të dizajnohet për Referencat Thelbësore Gjeografike (Core Reference Geographies), të cilat do të formojnë korniza pune të përbashkëta të informacionit që janë të përcaktuara, miratuara dhe të përdorura nga të gjithë mbajtësit e të dhënave në sektorin publik dhe privat. Këto Referenca Thelbësore Gjeografike (Core Reference Geographies) janë të dhëna që përdoruesi mund t'i besojë –të dhënat më të mira në dispozicion për një zonë, të certifikuar, të standardizuara dhe të përshkruara sipas një standardi të përbashkët. Ato ofrojnë një bazë mbi të cilën organizatat mund të ndërtojnë duke shtuar detaje të tyre dhe duke hartuar tërësi të informacioneve të tjera (Bossler et al., 2015)

Secila Referencë e Përbashkët Gjeografike (Core Reference Geographies) duhet të jetë nën mbikëqyrjen e një organi të caktuar të sektorit publik (ose organeve - ku mirëmbajtja e komponentëve të asaj Reference Kryesore Gjeografike (Core Reference Geographies) është ndarë për arsye operative). Secili duhet të menaxhohet me standardet e publikuara të miratuara nga Këshilli i IKIH-së në konsultim me departamentet dhe organet përkatëse. Në shumicën e rasteve kjo do të jetë e përshtatshme për Referencën Kryesore Gjeografike (Core Reference Geographies) që të jetë zyrtarisht në pronësi të sektorit publik, edhe pse grumbullimi operativ dhe të mirëmbajtja do të mund të sigurohen nga sektorët publikë dhe / ose privatë.

Referencat Thelbësore Gjeografike (Core Reference Geographies) fillestare duhet të jenë: Korniza e punës Gjeodezike; Harta Topografike (në shkallë të ndryshme duke përfshirë informacionin për lartësinë e terrenit); Emrat Gjeografikë; Adresat; Rrugët; Toka dhe Pronësia e Pronës; Hidrologjia / Hidrografia; Kufijtë Statistikorë dhe Kufijtë Administrativë. Lista e Referencave Thelbësore Gjeografike (Core Reference Geographies) është një linjë me të radhiturat në Shtojcën I dhe II të Direktivës INSPIRE dhe (draft Ligjit) 'Ligji për themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës' dhe është vendosur në fund të Shtojcës 4. Për më tepër, gjithashtu janë në linjë me temat e të dhënave të Kornizës të punës së IKIH-së (Bossler et al, 2015).

Këshilli i IKIH-së duhet të mbajë listën e caktuar të Referencave Thelbësore Gjeografike (Core Reference Geographies). Ai duhet të vendosë dhe të publikojë kriteret për Referenca Thelbësore Gjeografike (Core Reference Geographies) shtesë. Duhet ta ketë parasysh, kur dhe ku është e përshtatshme të caktohen datasetet shtesë si Referenca Thelbësore Gjeografike (Core Reference Geographies) në përputhje me kriteret dhe pas konsultimit me ofruesit e të dhënave dhe përdoruesit.

Themelimi i infrastrukturës për ndarjen e informacionit gjeohapësinorë

Shkëmbimi i informacionit kërkon një bazë të përbashkët të marrëdhënieve të biznesit dhe proceseve të biznesit, i mbështetur nga biznesi dhe standardet teknike të infrastrukturës të TI-së të cilat së bashku sigurojnë ndërveprim në tërë sektorin publik dhe më gjerë.

Këshilli i IKIH-së duhet të zhvillojë dhe miratojë portofolin e Standardeve të Informacionit Gjeohapësinorë për t'u përdorur në sektorin publik. Për Informacionin Gjeohapësinorë, kjo do të zgjerohet dhe do të zhvillojë parimet e përgjithshme të Kornizës Evropiane të Ndërveprimit për Shërbimet pan-Evropiane e-Qeveritare (Komunitetet Evropiane, 2004). Korniza për Standardet e Informacionit Gjeohapësinorë do të bazohet në Standardet e Hapura të duhura. Standardet jo vetëm që duhet të mbulojnë formatet teknike, por edhe kuptimin e biznesit dhe proceset.

Çdo pronar i dataseveve duhet të përshtatë Standardet e miratuara të Informacionit Gjeohapësinorë me datasetet e tyre. Kjo do të arrihet kryesisht përmes Rregullave të Zbatimit të INSPIRE. Megjithatë, çdo ndryshim i nevojshëm të Referencat Thelbësore Gjeografike (Core Reference Geographies) duhet të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të japin një shërbim të qëndrueshëm dhe të bazuar në standarde për përdoruesit e tyre. Përveç kësaj, Këshilli i IKIH-së duhet të identifikojë çdo dataset tjetër ku konvergjenca e mëhershme të standardeve të dakorduara do të japin vlera të rëndësishme të biznesit për përdoruesit e dataseveve apo do të lejojnë që të dhënat të ndahen dhe të shfrytëzohen më gjerësisht. Çdo pronar i dataseveve duhet t'i dakordojë planet e tyre me Këshillin e IKIH-së dhe t'i publikojë ato si pjesë e informacionit të dataseveve të tyre.

Çdo pronar i dataseveve (Referencave Thelbësore Gjeografike si dhe dataseveve të tjera gjeohapësinorë) duhet t'i thjeshtësojë marrëveshjet e tyre të licencimit në mënyrë që të lehtësojë shkëmbimin e të dhënave për realizimin e vlerës më të madhe të përgjithshme. Kjo është në përputhje me marrëveshjet për shkëmbim, të kërkuara nga INSPIRE si dhe (draft ligjit) 'Ligji për themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës'.

Këshilli i IKIH-së në konsultim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit duhet të përcaktojë udhëzime dhe standarde minimale për thjeshtësim. Thjeshtësimi duhet të përfshijë:

- konvergjenca të Termeve dhe Kushteve të cilat janë çështje të përbashkëta dhe janë kryesisht datasete neutrale
- qasje të zakonshme ndaj 'çështjeve për të dhënat e nxjerra' për krijimin e dataseveve nga të dhënat e referencës, të cilat potencialisht mund të jenë zëvendësim për të në tregun komercial.
- futja e licencave zhvillimore dhe jo-komerciale për të nxitur inovacionin.

Sa i përket thjeshtësimit duhet marrë parasysh natyrën e biznesit të pronarëve të Referencës Thelbësore Gjeografike (Core Reference Geographies) dhe shqyrtimi i veçantë i Qeverisë nuk duhet

dyfishuar lidhur me çmimet e informacionit në sektorin publik nga fondet tregtare. Thjeshtimi duhet gjithashtu të sigurojë që e drejta e autorit është e mbrojtur në mënyrë adekuate.

Agjencia e Shoqërisë së Informacionit duhet shtyjë përpara zbatimin e infrastrukturave të TIK-ut të cilat lejojnë palët e interesit të ndajnë shërbimet gjeohapësinore të informacionit brenda dhe nëpër gjithë organizatat. Agjencia e Shoqërisë së Informacionit duhet të sigurojë koordinim më të madh për investime e TIK-ut në mënyrë që të krijojë ndarjen e shërbime të informacionit duke u bazuar në ueb dhe të ngrisë dukshëm efikasitete të rëndësishme në tërë sektorin publik.

Organet e sektorit publik duhet të formojnë dhe të promovojnë partneritete lokale, kombëtare ose funksionale për të shfrytëzuar informacionin gjeohapësinorë i cili është në dispozicion të infrastrukturës teknike të përbashkët. Kjo është në përputhje me lëvizjet e mëdha për t'u bashkuar ofrimin të shërbimeve publike të përcaktuara në vizionin e BE-së për shërbimet publike (Komisioni Evropian, 2013), si dhe aftësitë për të lidhur dhe për të ndarë informacionin në baza gjeohapësinore do vetë mundësojë shpërndarjen e shërbimeve më të integruara. Gjithashtu edhe partneriteti do të japë ekonominë e shkallës dhe gjithashtu do të mbështesë zbatimin e INSPIRE dhe të (draft ligjit) 'Ligjin për themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës'. Këshilli i IKIH-së duhet të hartojë udhëzime dhe modele për termat e referencës për partneritete të tilla; gjithashtu duhet të lehtësojë krijimin e partneriteteve në mënyrë aktive; dhe duhet të promovojë shkëmbimin e njohurive për arritjen e suksesit përmes partneriteteve të tilla.

Departamentet qeveritare dhe organet tjera publike duhet të krijojnë një numër të pilotëve dhe të ndërmarrjeve të përbashkëta, për të inkurajuar adoptimin e standardeve dhe qasjeve të reja duke krijuar shërbime inovative të reja publike dhe duke kombinuar të dhënat e ndryshme të qeverisë (për shembull, në kontekstin e masave agro-mjedisore, licencimin e minierave apo shërbimeve emergjente).

Një infrastrukturë efektive dhe efikase e informacionit gjeohapësinorë do të kërkojë investime dhe ndryshime të programeve, të cilat do të kërkojnë një horizont të planifikimit strategjik afat-gjatë sesa që normalisht është e mundur të bëhet në një periudhë të vetme të rishikimit të buxhetit. Këshilli i IKIH-së në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit duhet të zhvillojë një plan strategjik dhe një kornizë pune të biznesit e cila përcakton një periudhë të mjaftueshme të sigurisë dhe parashikueshmërisë (duke përfshirë financimin dhe çmimin) për pronarët e dataseteve dhe përdoruesit për të bërë investimet e nevojshme.

Aftësitë dhe Njohuria

Dërgimi i rezultateve të Strategjisë kërkon një ndryshim të madh në aftësim për ta kuptuar dhe përdorur informacionin gjeohapësinorë, dhe për t'i shkëmbyer më mirë njohuritë dhe praktikën më të mira. Me rëndësi është që aftësitë dhe njohuritë rreth çështjeve gjeohapësinore duhet lëvizur nga komuniteti specialist i kufizuar në rrjedhën e zhvillimit të politikave, dizajnit të shërbimeve dhe shpërndarjes së sistemeve.

Këshilli i IKIH-së duhet të udhëheqë një program për ndërtimin e kapaciteteve për të ngritur vetëdijen për informacionin gjeohapësinorë dhe aftësitë analitike si një mjet biznesi mundësues nëpër shërbime publike dhe profesione. Kjo duhet informuar duke bërë një auditim fillestar, jo vetëm për aftësitë e tanishme, por edhe për kërkesat e ardhshme. Përdorimi më inovativë i informacionit gjeohapësinorë në sektorin publik momentalisht është përqendruar në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve që përfshinë drejtëpërdrejtë mjedisin fizik, siç është planifikimi Hapësinorë, transportimi, minierat dhe menaxhimi i mjedisit. Përhapja më e gjerë dhe shfrytëzimi i informacionit

gjeohapësinorë është sporadik në të gjitha pjesët e tjera të sektorit publik. Faktor kontribuues është mungesa e ndërgjegjësimit dhe aftësive të nevojshme, veçanërisht në mesin e menaxherëve të përgjithshëm, projektuesve të shërbimeve dhe profesionistëve mbështetës siç është profesioni i TI-së. Kështu që, programi për ngritjen e kapaciteteve duhet të ndërmarrë iniciativat ekzistuese të ndërtimit të kapaciteteve të mundshme kudo që të jetë e mundur, siç janë punëtoritë, takimet dhe seminarët.

Këshilli i IKIH-së duhet të nxisë shkëmbimin e njohurive rreth informacionit gjeohapësinorë si dhe metodat dhe aplikimet e tyre brenda dhe jashtë sektorit publik. Duhet të komunikojë (përdorimin) lidhur me studimin e rasteve dhe shembujve të praktikave të mira, duke përfshirë shembuj brenda një organizate që mund të adoptohet nëpër një grup më të gjerë të organizatave. Duke vepruar kështu, duhet të punojnë ngushtë me sektorin për inovacione specifike dhe grupet e përmirësimeve. Duhet të krijojë rrjete dhe komunitete të interesit për të siguruar pjesëmarrje të vazhdueshme, angazhim dhe shkëmbim të njohurive.

Këshilli i IKIH-së dhe Agjencia e Shoqërisë së Informacionit duhet të dakordohen për një program pune për të siguruar në mënyrë reciproke që çështjet gjeohapësinore janë kuptuar më mirë nga komuniteti i gjerë i TI-së dhe që çështjet e TI-së janë kuptuar më mirë nga komuniteti gjeohapësinorë.

Qeverisja dhe Udhëheqja

Shpërndarja - dhe më pas mbajtja – e përfitimeve të arritura nga qasja e re ndaj informacionit gjeohapësinorë e përshkruar në këtë Strategji do të kërkojë udhëheqje të qartë, të lartë dhe të fortë të menaxhimit, autoritative dhe qeverisje ndër sektoriale. Ekipi ekzistues i Strategjisë të IKIH-së ka sjellë së bashku udhëheqës të lartë nga sektori publik nga të cilët duhet të jetë ndërtuar.

Prandaj, Qeveria duhet të krijojë një Këshill të ri, të bazuar në propozimin e ekipit të Strategjisë së IKIH-së, për të ofruar këtë Strategji të IKIH-së, zbatimin e INSPIRE, "Ligjin për themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës" dhe iniciativat e ndërlidhura. Duhet të sjellë profesionistë të lartë në qeveri për të siguruar rezultate të përbashkëta për shërbimet publike efektive dhe efikase përmes veprimit të koordinuar dhe konvergencë në praktikat më të mira. Duhet të: jetë një Këshill përfshirës me një pasqyrë të të gjitha iniciativave gjeohapësinore të sektorit publik në nivelet e qeverisjes lokale dhe qendrore; duhet të zhvillojë Planin e Zbatimit për Strategjinë e IKIH-së si dhe të menaxhojë, koordinojë dhe zbatojë Strategjinë e IKIH-së përkrah Direktivës INSPIRE dhe (draft ligjit) 'Ligji për themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës'; duhet të veprojë si Grup Drejtues për të koordinuar në Kosovë shpërndarjen e zbatimit të Direktivës INSPIRE dhe 'Ligjin për themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës'; si dhe të marrë rolin udhëheqës në vazhdimin e çështjeve strategjike në lidhje me informacion gjeohapësinorë dhe përdorimin e saj, duke përfshirë:

- monitorimin e zhvillimeve teknike, ndërveprimit dhe shkëmbimit të informacionit brenda së cilës është grumbulluar dhe menaxhuar informacioni gjeohapësinorë;
- promovimin e praktikave më të mira dhe përkrahjen e inovacionit në grumbullimin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinorë;
- Lehtësimin e pozitave koordinuese për legjislacionin e mundshëm që mund të kenë ndikim në tregun e informacionit gjeohapësinorë;
- trajtimin e cilësisë së të dhënave dhe çështjeve të integritetit, dhe në veçanti shikimin e një pasqyre të gjerë dhe strategjike lidhur me kërkesat për investime;

- artikulumin e produktivitetit ekonomik dhe kombëtarë dhe konkurrencën për përfitimet e një IKIH-je efektive për Republikën e Kosovës, dhe
- identifikimin e çështjeve të tjera të mesme- afatgjatë gjeohapësinore.

Këshillojë Ministrin përgjegjës në përputhje me rrethanat (dhe përmes këtij Ministri, sipas rastit, administratat e zhvilluara) dhe, nën autoritetin e Ministrit përcakton standardet, politikat dhe kërkesat për zbatim për ata që janë përfshirë në informacionin gjeohapësinorë dhe përdorimin e tij; i raporton qeverisë një herë në vit mbi progresin e zbatimit të kësaj Strategjie dhe çështjeve ndër-qeveritare që kërkojnë vendime Ministrore; dhe publikon Raportin Vjetor të aktiviteteve të tij mbi progresin e zbatimit të kësaj Strategjie dhe të propozimeve për veprim të mëtejshëm strategjik për të shtuar vlerën e fituar nga informacioni gjeohapësinorë.

Këshilli i IKIH-së duhet të ketë një përfaqësues të anëtarëve të të gjitha palëve kryesore të interesit publikë i cili do të veprojë së bashku për të mundësuar ofrimin e përfitimeve të përbashkëta. Kjo duhet të përfshijë të gjitha organizatat e radhitura në shtojcën 1.

Këshilli i IKIH-së duhet të përkrahë dhe të këshillohet nga Komiteti i IKIH-së dhe nga katër Grupe Punuese. Qëllimi i Komitetit të IKIH-së është të shërbejë si grup i dërgesave menaxheriale dhe operacionale duke siguruar zhvillimin e aktiviteteve të duhura, të koordinuara në kohën e duhur dhe me standarde të duhura të cilësisë me qëllim të zbatimit të IKIH-së të Kosovës dhe aktiviteteve të kërkuara që kanë lidhshmëri me këtë fushë. Qëllimi kryesor i Grupeve Punuese është që të ofrojë njohuri të specializuara të ekspertëve dhe opinione për vendimmarrje në nivel të Këshillit, dhe të mbështesë Komitetin me shpërndarjen e IKIH-së. Për temat në vijim, do të jenë katër Grupe Punuese siç janë: 1) Çështjet ligjore dhe institucionale; 2) çështjet teknologjike; 3) Marrëdhëniet me Publikun (MP), Komunikimet dhe Ngritja e Kapaciteteve ; dhe 4) Modeli i biznesit. Në të ardhmen, ka mundësi që duhet shtuar edhe grupe të tjera punuese p.sh. grupe punuese të cilat merren me çështje siç është inovacioni (H dhe Zh)

Struktura e propozuar e qeverisjes është përcaktuar në shtojcën 5. Këshilli i IKIH-së, Komiteti i IKIH-së dhe Grupet e Punuese do të përfshijnë rolin e Ekipit të Strategjisë së IKIH-së dhe do të themelohet një vit e gjysmë pas miratimit të kësaj Strategjie nga qeveria.

Shpenzimet dhe Përfitimet

Shpenzimet aktuale për krijimin e IKIH-së janë vlerësuar të jenë rreth 1,300,000 Euro dhe shpenzimet vjetore të vazhdueshme janë vlerësuar të jenë rreth 450,000 Euro. Këto shifra janë marrë nga konsulentët e Ekipit të Strategjisë së IKIH-së gjatë punës së tyre për të zhvilluar Strategjinë e IKIH-së. Këto kosto nuk përfshijnë tërësinë e informacionit krijimin / përvetësimin e Referencës Thelbësore Gjeografike (Core Reference Geographies). Shtojca 6 paraqet një pasqyrë të IKIH-së për vlerësimet e koston për implementim.

Përfitimet strategjike

Nga kjo Strategji do të përfitojë qeveria, sektori i gjerë publik, sektorit privat dhe qytetarët gjatë qasjes, ndarjes apo ri-përdorimit të informacionit gjeohapësinorë. Arritja e objektivave për departamentet e qeverisë dhe organeve të tjera publike do të lehtësohet duke i integruar më shumë asetet e informacionit me një kornizë pune referente të thjeshtë, të ruajtur mirë dhe lehtësisht të arritshme, duke çuar në zhvillimin e politikave të mirë informuara dhe të ofrimit të shërbimeve. Përmbledhja e ndryshimeve operacionale që do ta mbështesë Strategjia e IKIH-së janë paraqitur në shtojcën 3.

Strategjia pritet të realizojë kursimet financiare duke shmangur dyfishimin e sistemeve si dhe të grumbullimit të të dhënave, si dhe kursimet financiare indirekte dhe të paprekshme me vendime më të mira të politikave dhe ofrimin e shërbimeve të mundësuar nga përdorimi më i mirë dhe shkëmbimi i informacionit gjeohapësinorë me miratimin e Strategjisë.

Në veçanti, Strategjia do të japë përfitime nëpërmjet:

- ngritjes së efikasitetit për grumbullim, mirëmbajtje, ndarje dhe ri-përdorim të qëndrueshëm të të dhënave të grumbulluara nga qeveria dhe nga sektori i gjerë publik (miratimi i parimeve të ngjashme do të mundësojë përfitime të ngjashme në sektorin privat)
- shkëmbimit më të mirë të të dhënave nëpërmjet zbatimit të standardeve të të dhënave efektive ndërvepruese të cilat do të përdoren nga qeveria dhe që mund të përdoren edhe nga sektori privat
- ofrimin të Referencave Thelbësore Gjeografike (Core Reference Geographies) për Republikën e Kosovës, të cilat ofrojnë një kornizë për të lidhur të gjitha të dhënat e tjera gjeohapësinore dhe në këtë mënyrë krijojnë mundësi për produktivitet më të madh dhe produkte të reja si dhe shërbime në sektorin publik, privat dhe të sektorët e tretë.
- sigurimit që Republika e Kosovës mund të zbatojë Direktivën e INSPIRE dhe 'Ligjin mbi themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës' në mënyrë të duhur dhe brenda afatit kohor.
- masave më efektive për qëndrueshmëri dhe për të menaxhuar efektet e ndryshimeve klimatike
- produktivitetit më të madh dhe shpenzime më të ulëta të transaksionit në sektorin privat dhe publik, dhe
- Përmirësimit të konkurrencës në Republikën e Kosovës.

Strategjia e IKIH-së gjithashtu do të mbështesë shpërndarjen efektive të iniciativave kryesore të qeverisë që do të përfitojnë nga politikat rigoroze dhe të përshtatshme të menaxhimit të informacionit gjeohapësinorë që përfshijnë regjistrimet e ardhshme; projektet e rigjenerimit; çështjet emergjente dhe të sigurisë; zhvillimet e qeverisjes vendore; ndryshimet klimatike dhe planifikimit të transportit afatgjatë.

Shpenzimet

Direktiva INSPIRE (dhe "Ligji për themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës") obligon shumë mbajtës të të dhënave ekzistuese për të kodifikuar dhe modifikuar të dhënat e tyre në mënyrë që të përputhen me Direktivën (dhe Ligjin). Shpenzimet për përmbushjen e këtyre kërkesave do të duhet të mbulohen nga buxhetet e brendshme të organizatave individuale dhe nuk janë përgjegjësi e Këshillit të IKIH-së dhe / ose Ministrisë përgjegjëse. Për të identifikuar më saktë kostot e zbatimit që lidhen me Direktivën INSPIRE (dhe Ligjin), së bashku me fondet e ndërlidhura, kjo do të jetë një detyrë e hershme e Komisionit për Këshillin e propozuar të IKIH-së. Kjo do të ndihmojë për të siguruar që një program i financuar siç duhet është vënë në vend, duke mbuluar si shpenzimet e veta ashtu edhe çdo kontribut të përshtatshëm përmes investimeve të përbashkëta. Zbatimi i plotë i Strategjisë i përcaktuar më sipër ka të ngjarë të pësojë disa shpenzime shtesë mbi vetë minimum, shpenzime të nevojshme për t'u përputhur me INSPIRE (dhe Ligjin). Megjithatë, në shumë raste, është parashikuar se shpenzimet shtesë mund të jenë relativisht të vogla për arsye se kostos kryesore (siç janë shpenzimet për zhvillim dhe implementim të sistemit) janë të njëjta. Përveç kësaj:

- Arritja e qëllimeve strategjike për modifikim të të dhënave, grumbullimin e të dhënave në të ardhmen, përdorimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave gjeohapësinore dhe lidhjen koherente

të të gjitha dataseteve do të japin përfitime të tjera të biznesit përtej përputhshmërisë së INSPIRE (dhe Ligjit), dhe kështu të japë një normë tërheqëse të kthimit të çdo investimi marxhinalë shtesë

- Zbatimi i Strategjisë në të njëjtën kohë kur duhet modifikuar edhe sistemet për INSPIRE (dhe Ligji) do të jetë shumë më i lirë - në të holla si dhe në kostot e mundshme siç mund të jetë mungesa e kuadrit – sesa duke bërë dy grupe të veçanta për ndryshime në dy kohë të veçanta, dhe
- Qasja strategjike e përshkruar, dhe qeverisja efektive për ta ofruar atë, duhet të identifikojë mundësitë për punë të përbashkët, standardizim dhe ri-përdorim të asetëve brenda planeve ekzistuese të zbatimit të INSPIRE (dhe ligjit), i cili do të lejojë disa prej burimeve ekzistuese të planifikuara të lirohen për të ofruar përfitime strategjike shtesë.

Megjithatë, për të filluar zbatimin e Strategjisë kërkohen edhe disa gjëra shtesë, si puna e infrastrukturës gjatë 36 muajve të parë pas miratimit të kësaj Strategjie nga qeveria, për të cilat nuk ekziston ndonjë dispozitë në buxhetet e departamenteve:

- Identifikimi dhe katalogimi i depove ekzistuese të sektorit publik i cili posedon asete të të dhënave gjeohapsinore, duke e vënë informacionin e duhur në dispozicion përmes modelit të federuar
- Zhvillimi i një kornize, një infrastrukture prototipe, mekanizmave dhe parimeve për praktikën më të mira për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e një burimi të ri qëndror të arritshëm, duke detajuar këto asete, duke përfshirë adoptimin (dhe nëse është e nevojshme përkufizimin) e të dhënave ekzistuese dhe standardeve të ndërveprimit
- Zhvillimi i aktiviteteve të duhura për shpërndarjen e Referencave Thelbësore Gjeografike (Core Reference Geographies) në kuadër të qeverisë për të përmbushur obligimet ndaj Direktivës INSPIRE dhe Ligjit për themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës, duke përfshirë udhëzime për ndryshimin e të dhënave kur është e nevojshme.

Këto detyra do të kërkohet të kryhen nga buxheti qëndror i kontribuar nga departamentet e palëve të interesit në kuadër të qeverisë qëndrore. Kjo do të lejojë krijimin e njësisë të menaxhimit në Komitetin e IKIH-së, nivelet e përshtatshme të delegimit për të lejuar kryerjen e punëve teknike të identifikuara më lartë dhe zhvillimin e një demonstruesi për të lehtësuar zbatimin e INSPIRE, "Ligjit për themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës" dhe për të përcaktuar metodologji për të përkrahur departamentet adoptuese.

Informacion i detajuar

Teksti i shkruar më lart është një përmbledhje nga pikat kryesore të 24 dërgesave të bëra për zhvillimin e kësaj Strategjie të cilat janë grupuar në gjashtë rrjedhat e mëposhtme: 1) Misioni/Vizioni Strategjik; 2) i Financat; 3) Struktura Qeverisë; 4) Shpërndarja dhe Ngritja e Kapaciteteve; 5) Rruga e Zbatimit; dhe 6) Raportimi. Rrjedha e Misionit 1 ishte ndarë në këto dërgesa: "Përputhshmëria me Politikën Kombëtare /Evropiane", "Misioni dhe Vizioni", "Objektivat", dhe "Lista e palëve të interesit". Rrjedha 2 për Financa ishte ndarë në këto dërgesa: "Modeli i Financimit", "Modeli për Partneritet", dhe "Analizat për Përfitimet e Kosotos". Rrjedha 3 Struktura e Qeverisjes ishte ndarë në këto dërgesa: "Kornizë pune e Qeverisjes", "Trupi Koordinues", "Grupet Punuese Ndërmministrorë" "Përfshirja dhe Angazhimi i Sektorit Publik/Privat", dhe "Plani i Komunikimit". Rrjedha 4 Shpërndarja dhe Ngritja e kapaciteteve ishte ndarë në këto dërgesa "Trajnimi i stafit të AKK-së", "Takimi i

Grupeve të Palëve të Interesit të IIH-së, "Përfshirja e Palëve të Interesit në Punëtori", "Zhvillimi i Përdorimit të Rasteve", "Pilot Aplikacionet", dhe "Materialet Promovuese". Rrjedha 5 Rruga e Zbatimit ishte ndarë në këto dërgesa "Skica e Planit të Programit", "Detyrat dhe Përgjegjësitë", "Monitorimi i Performancës", dhe "Menaxhimi i Rrezikut". Dhe, Rrjedha 6 ishte ndarë në këto dërgesa: "Strategjia e IKIH-së" dhe "Raporti Final". Çdo dërgesë krijon një raport më vete. Raportet e rezultateve mund të gjenden në: <http://www.kca-ks.org/>.

Referencat

Agency of Real Estate Cadastre, 2012. NSDI Strategy for the Republic of Macedonia.

Assembly of the Republic of Kosovo, 2011. Law on Cadastre No. 04 L/013 - Official Gazette of Republic of Kosovo Nr. 13 / 1 September 2011.

Assembly of the Republic of Kosovo, forthcoming. Law on the Establishment of a National Spatial Data Infrastructure in the Republic of the Republic of Kosovo. Draft version.

Bossler, J.D., Cowen, D.J., Geringer, J.E., Carson Lambert, S., Moeller, J.J., Rust, Th.D., and Welch, R.T., 2015. Report Card on the U.S. National Spatial Data Infrastructure – Compiled for the Coalition of Geospatial Organizations. February 6, 2015.

Commission of the European Communities, 2007. Directive 2007/2/EC of the European Parliament and of the Council of 14 March 2007. Establishing an Infrastructure for Spatial Information in the European Community (INSPIRE). Official Journal of the European Union L108, 1-14.

Danish Ministry of the Environment – National Survey and Cadastre. Location – a Gateway to eGovernment. Strategic basis. The National Survey and Cadastre 2011-2015.

European Commission, 2013. A vision for public services. Directorate-General for Communications Networks, Content and Technology.

European Communities, 2004. European Interoperability Framework for Pan-European eGovernment Services.

Longhorn, R. and Blakemore, M., 2008. Geographic Information: Value, Pricing, Production, and Consumption. CRC Press.

Masser, I. and Cromptoets, J., 2015. Building European Spatial Data Infrastructures. Third Edition. ESRI Press.

Meha, M., Cromptoets, Çaka, M., and Rexha, A., 2014. Developing a strategy for the National Spatial Data Infrastructure of the Republic of Kosovo. In: Proceedings of the SDI Days 2014. Zagreb. Croatia, 11-12 September 2014, 5 pgs, pp. 60-64.

Nushi, B., Van Loenen, B., Besemer, J., and Cromptoets, J., 2012. Multi-view SDI Assessment of Kosovo (2007-2010) – Developing a Solid Base to Support SDI Strategy Development. In: A. Rajabifard, and D. Coleman (Eds.), Spatially Enabling Government, Industry and Citizens: Research and Development Perspectives. GSDI Association Press, United States, pp. 253-275.

Oxera, 2013. What is the Economic Impact of Geo Services? Oxford: Oxera. Google.

Vickery, G., 2011. Review of recent studies on PSI re-use and related market developments.

Shtojca 1: Historiku për krijimin e Strategjisë për Infrastrukturën Kombëtare për Informacion Gjeohapësinorë të Kosovës

Ekipi i Strategjisë për Infrastrukturën Kombëtare për Informacion Hapësinorë (IKIH)

Ekipi i Strategjisë së IKIH-së ishte një grup i themeluar në vitin 2014 për përgatitjen e kësaj Strategjie. Qëllimi ishte të ngritët vetëdija, të angazhohen palët e interesit, të merren mendime mbi rezultatet (ndër) mediate, të promovohet një qasje koherente dhe gjithëpërfshirëse për menaxhimin e informacionit gjeohapësinorë në Republikën e Kosovës. Ky ekip është udhëhequr nga Agjencia Kadastrale e Kosovës me mbështetje të konsulentëve të jashtëm nga KU Leuven (Belgjikë).

Anëtarët e Ekipit të Strategjisë të IKIH-së kryesisht prezantojnë grupet kryesore të interesit në Qeverinë e Republikës të Kosovës. Në Pranverë të vitit 2015 ishin anëtarësuar:

- Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
- Asociacioni i Komunave të Kosovës
- Asociacioni i Ujërave të Kosovës
- Ndërmarrja Hidro-ekonomike Ibër Lepenci
- Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
- Agjencia Kosovare e Privatizimit
- Agjencia e Statistikave të Kosovës
- Agjencia Kadastrale e Kosovës
- Policia e Kosovës
- Agjencia Kosovare e Pronës
- KUR Prishtina si dhe kompani të tjera të ujësjellësit
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik duke përfshirë Matjet Gjeologjike të Kosovës dhe Agjencinë e Kosovës për Energji Efiçente
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë duke përfshirë Institutin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Institutin për Planifikim Hapësinorë dhe Institutin Hidrometeorologjik
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit
- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Infrastrukturës
- Ministria e Punëve të Brendshme
- Ministria e Forcës së Sigurisë të Kosovës
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
- Ministria e Administratës Publike
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina
- Ujësjellësi Radoniqi

Situata në fillimin e punës në Strategjinë për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinorë për Republikën e Kosovës

Qeveria e Kosovës është në dijeni për rëndësinë e zhvillimit të IKIH-së dhe në përputhje me Ligjin për Kadastër No.04 L/013. Kjo përgjegjësi i'u është caktuar Agjencisë Kadastrale të Kosovës për marrjen e iniciativës me Nenin 23. Agjencia Kadastrale e Kosovës është një agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë (MMPH), dhe përveç çështjeve të ndërlidhura me zhvillimin e IKIH-së të Kosovës, kryesisht është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e kadastrit në Republikën e Kosovës. Me qëllim të zbatimit të suksesshëm të IKIH-së, duket të jetë e nevojshme që të ketë një plan të nivelit të lartë për të arritur një ose më shumë qëllime lidhur me zhvillimin e IKIH-së. Prandaj, rekomandohet që të formulojë një strategji gjithëpërfshirëse për zhvillimin e IKIH-së në Republikën e Kosovës.

Edhe pse, disa nisma të fundit në kontekstin e menaxhimit të informacionit gjeohapësinorë kanë sjellë përfitime për organizatën ose juridiksionin e tyre (shih p.sh. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Agjencia Kadastrale e Kosovës (p.sh. Gjeoportali: <http://geoportal.rks.gov.net/>), Agjencia e Statistikave të Kosovës, KUR Prishtina, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë), përpjekjet e tilla kanë qenë gradualisht në lidhje me vetë informacionin gjeohapësinorë, pjesërisht të mbuluara dhe të pashmangshme, nuk kanë qenë në gjendje që ta mbështesin plotësisht qeverinë transformuese; është e mundshme që realizimi i këtyre ndryshimeve nuk ka ndodhur në mungesë të një përkrahësi të rëndësishëm.

Dihet se ka mundësi që forma e "Ligjit për themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës" e cila është në linjë të fortë me Direktivën e BE-së INSPIRE, të ratifikohet nga Parlamenti i Kosovës. Kjo do të kërkojë që Kosova të krijojë një kornizë gjithëpërfshirëse strategjike për të mbështetur ligjin dhe zbatimin Direktivës të BE-së në të gjitha të dhënat e grumbulluara në tërë sektorin publik në Republikën e Kosovës, të cilat kanë të bëjnë me informacionet e tyre me lokacionin. Është dakorduar që Strategjia e propozuar e IKIH-së për Republikën e Kosovës duhet përmbushur kërkesat e Direktivës INSPIRE të BE-së dhe gjithashtu të shtojë në maksimum shfrytëzimin dhe përfitimin nga informacioni gjeohapësinorë për të siguruar një kornizë pune për të drejtuar nisma lokale gjeografike.

Konsultimi për mbështetjen e formulimit të Strategjisë të IKIH-së për Republikën e Kosovës

Për formulimin e Strategjisë janë përfshirë mbi 100 palë kryesore të larta të interesit dhe ekspertë teknikë kryesisht nga sektori publik. Shtojca 2 paraqet palët e interesit të konsultuara. Disa palë të interesit dhe organizata kanë dhënë komente me shkrim. Raporti gjerësisht pasqyron pikëpamjet e grumbulluara nga palët e interesit dhe rezultatet e mëdha të këtyre konsultimeve. Marrëveshja ishte pozitive, që Strategjia e IKIH-së për Republikën e Kosovës është e nevojshme për të kuptuar dhe shtuar deri në maksimum përfitimet e informacionit gjeohapësinorë në vend.

Shtojca 2: Zhvillimi I Strategjisë për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinorë të Kosovës dhe lista e palëve të interesit të cilët janë konsultuar

Strategjia e IKIH është zhvilluar në gjashtë rrjedha të procesit. Ka filluar në shkurt të vitit 2014 kur përqendrimi ishte në vizionin strategjik, misionin dhe objektivat e ndjekura nga çështjet financiare, strukturën e qeverisjes, shpërndarjen, dhe ngritjen e kapaciteteve në kontekst të zhvillimit të një IKIH-je për Kosovën. Aktivitetet e fundit janë përqendruar në udhërrëfyesin për zbatimin e IKIH-së.

Pjesa më e madhe e punës në terren u përfundua në prill të vitit 2015. Puna në terren përfshinte organizimin e takimeve me grupet e mundshme të interesit të IKIH-së të Kosovës, vizitat në organizatat e palëve kryesore të interesit (në mënyrë që të kenë njohuri për nevojat dhe aktivitetet e tyre të IKIH-së), dhe mbajtjen e punëtorive përkatëse. Tabelat e mëposhtme pasqyrojnë takimet e organizuara, vizitat e bëra, dhe punëtoritë. Në vitin 2014 dhe 2015 është kaluar shumë kohë strategjike për të pozicionuar Strategjinë brenda programit të punës të qeverisë INSPIRE dhe të "Ligjit për themelimin e një Infrastrukture për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës", dhe gjithashtu strategjitë e tjera kombëtare gjeohapsinore.

Tabela: Pasqyrë e takimeve me palët potenciale të interesit të IKIH-së

Numri	Data	Nikoqir	Numri i pjesëmarrësve
1	20 Mars 2014	Agjencia Kadastrale e Kosovës	16
2	7 Maj 2014	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë	19
3	3 Korrik 2014	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	15
4	25 Shtator 2014	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	15
5	6 Nëntor 2014	Ministria e Shëndetësisë	21
6	5 Shkurt 2015	KUR Prishtina	30
7	2 Prill 2015	Ministria e Administratës Publike	28

Tabela: Pasqyrë e vizitave të bëra në organizatat e palëve kryesore të interesit

Data e vizitës	Organizata e palëve të interesit
8 Maj 2014	Instituti Hidrometeorologjik
2 Korrik 2014	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
24 Shtator 2014	Ministria e Infrastrukturës
24 Shtator 2014	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
5 Nëntor 2014	Ministria e Shëndetësisë
5 Nëntor 2014	Agjencia e Statistikave të Kosovës
5 Nëntor 2014	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë
3 Shkurt 2015	Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
3 Shkurt 2015	Asociacioni i Komunave të Kosovës
6 Shkurt 2015	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
31 Mars 2015	Agjencia Kosovare e Pronës
31 Mars 2015	Policia e Kosovës
31 Mars 2015	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
3 Prill 2015	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Tabela: Pasqyrë për Punëtoritë e organizuara

Nr.	Titulli i Punëtorisë	Date
1	Hyrje në Infrastrukturën e të Dhënave Hapësinore	4 Korrik 2014
2	Ndërveprimi dhe standardizimi	26 Shtator 2014
3	Gjeo-portali, grumbullimi dhe shpërndarja e të dhënave gjeoHapësinorë	11 Dhjetor 2014
4	Strategjia e IKIH-së e Kosovës	1 Prill 2015

Palët e interesit të cilët gjenden ne tabelën më poshtë kanë marrë pjesë në takime strategjike apo punëtori për të përkrahur formulimin e Strategjisë të IKIH-së nga organizatat e palëve të interesit.

Tabela: Pasqyrë e palëve të interesit të involvuara në procesin e zhvillimit të strategjisë së IKIH.

Emri	Organizata
Kujtim Gashi	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
Selim Lulaj	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
Halim Thaçi	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
Shqipe Arifaj	Asociacioni i Komunave
Ramadan Klisurica	Asociacioni i Komunave
Ismail Gagica	BE Implemetimi dhe Zbatimi i Planifikimit Hapësinorë Rural (IRUSP)
Blerton Hoxha	BE Implemetimi dhe Zbatimi i Planifikimit Hapësinorë Rural (IRUSP)
Premtim Ipshi	BE Implemetimi dhe Zbatimi i Planifikimit Hapësinorë Rural (IRUSP)
Boris Leukert	BE Implemetimi dhe Zbatimi i Planifikimit Hapësinorë Rural (IRUSP)
Adam Podolscak	BE Implemetimi dhe Zbatimi i Planifikimit Hapësinorë Rural (IRUSP)
Marianna Posfai	BE Implemetimi dhe Zbatimi i Planifikimit Hapësinorë Rural (IRUSP)
Asim Rragomi	Ndërmarrja Hidro-ekonomike N.P.H Iber Lepenci
Alisa Berisha Avdiu	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Sami Duraku	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Ramiz Krasniqi	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Besa Zeqiraj Morina	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Gazmend Morina	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Sami Preteni	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Edvin Cacaj	Geo-2000
Sabri Zylfiu	Geo Consulting
Durim Zylfiu	Geo Consulting
Jetmir Avdiaj	Geoling
Selajdin Haxhimurati	Geomodelling
Bejtullah Shehu	Geomodelling
Enis Hoda	Geopro
Qemajl Hoda	Geopro
Afet Axhami	Gjeomatje Shpk
Argjend Nela	IT, Engineering & GIS Solutions
Adriatik Sejdia	IT, Engineering & GIS Solutions
Agron Luta	Agjencia Kosovare e Privatizimit
Ardita Hajredini Isufi	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Haki Kurti	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Idriz Shala	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Rrahman Tara	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Murat Meha	Agjencia Kadastrale e Kosovës
Violeta Hajdari	Agjencia Kadastrale e Kosovës
Muzafer Çaka	Agjencia Kadastrale e Kosovës
Habibe Metushi	Agjencia Kadastrale e Kosovës
Denis Pitarka	Agjencia Kadastrale e Kosovës
Arbresha Rexha	Agjencia Kadastrale e Kosovës
Qazim Sinani	Agjencia Kadastrale e Kosovës
Arbresha Starabaja	Agjencia Kadastrale e Kosovës
Besfort Thaçi	Agjencia Kadastrale e Kosovës
Albina Blakaj	Zyra Kadastrale Komunale e Prishtinës
Afërdita Çekaj Thaçi	Policia e Kosovës
Gazmend Krasniqi	Policia e Kosovës
Hajrush Lenjani	Policia e Kosovës

Arben Canolli	Agjencia Kosovare e Pronës
Safete Isufi	KUR Prishtina
Lufti Kodra	KUR Prishtina
Jetish Krasniqi	KUR Prishtina
Nehru Maloku	KUR Radoniqi
Arben Pruthi	KUR Radoniqi
Burbuqe Bajrami Deva	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Valon Berisha	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Skender Sallahi	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Nol Zekolli	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Përparim Gashi	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë / Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
Letafete Latifi	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë / Instituti Hidrometeorologjik I Kosovës
Bajram Kafexholli	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë / Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
Mentor Shala	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë / Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
Rizah Murseli	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë
Shkumbin Shala	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë
Idriz Gashi	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Fetije Muriqi	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Arjeta Drenica	Ministria e Shëndetësisë
Hysni Dvorani	Ministria e Shëndetësisë
Albert Sutaj	Ministria e Shëndetësisë
Fatlume Uka	Ministria e Shëndetësisë
Xhevat Ukaj	Ministria e Shëndetësisë
Samedin Gerxhaliu	Ministria e Infrastrukturës
Besnik Hajdari	Ministria e Infrastrukturës
Naim Kelmendi	Ministria e Infrastrukturës
Hysen Merofci	Ministria e Infrastrukturës
Sokol Gashi	Ministria e Punëve të Brendshme
Hysen Gecaj	Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
Afrim Xani	Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
Dugagjin Ethem	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Xhevahire Beqiri	Ministria e Administratës Publike
Shengjyle Betashi	Ministria e Administratës Publike
Shefki Gashi	Ministria e Administratës Publike
Xhevdet Hetemi	Ministria e Administratës Publike
Ajshe Kamberi	Ministria e Administratës Publike
Armend Kastrati	Ministria e Administratës Publike
Mimoza Kurteshi	Ministria e Administratës Publike
Saranda Maloku	Ministria e Administratës Publike
Laureta Mulliqi	Ministria e Administratës Publike
Jehona Murtezaj	Ministria e Administratës Publike
Blerim Mustafa	Ministria e Administratës Publike
Adil Bytyqi	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Isa Dukaj	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Kreshnik Thaçi	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Lumturie Geci	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Mesud Kuka	Kompania e Ujësllësit Rajonal Hidrodrini Pejë
Halil Peli	Kompania e Ujësllësit Rajonal Hidrodrini Pejë

Vehbi Duraku	Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina
--------------	--------------------------------------------

Në formulimin e Strategjisë të IKIH-së të Republikës së Kosovës janë përfshirë dy konsulentë të Ku Leuvenit, me shumë përkrahje nga stafi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës (Murat Meha, Muzafer Çaka, Denis Pitarka, dhe Arbresha Rexha).

Tabela: Lista e Konsuletëve

Emri	Organizata
Joep Crompvoets	KU Leuven Instituti për Qeverisjen Publike
Danny Vandenbroucke	KU Leuven –Divizioni i Aplikacioneve Hapësinorëe Leuven

Përfundimisht, Kathrine Kelms (Banka Botërore), Zdravko Galiç (konsulentët e TI për Bankën Botërore) dhe Bujar Nushi e kanë rishikur tekstin final të kësaj Strategjie.

Shtojca 3: Përmbledhje e ndryshimeve operacionale që do të lehtësohen me zbatimin e Strategjisë për Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Hapësinorë

Tema	Nga	Në
Qasje në Metadata	Qasja e papajtueshme për regjistrimin e detajeve të rëndësishme lidhur me të dhënat e marra (Metadata)	Krijimin dhe zbatimin e një metode të qëndrueshme për regjistrim të metadatave dhe ruajtja e këtyre artefakteve në një vend lehtësisht të arritshëm
Të dhënat referente thelbësore	Mungesa e qëndrueshmërisë dhe qartësisë mbi të dhënat gjeohapësinorë që përcakton dhe përforcon informacionin gjeohapësinorë të Kosovës	Zhvillimi i një numri të referencave thelbësore gjeografike duke formuar një kornizë të përbashkët në të cilin dërgesat e INSPIRE që lidhen me 'Ligjin për krijimin e infrastrukturës për Informacion Hapësinorë' mund të përmbushen
Shkëmbimi i të dhënave	Mungesa e standardeve të ndërveprimit nga informacioni gjeohapësinorë dhe/ose adaptimi i atyre që ekzistojnë	Standardet e hapura për informacion gjeohapësinorë (ISO & OGC) të përshtaten në mënyrë të vazhdueshme në tërësinë e të dhënave gjeohapësinore të Kosovës, duke krijuar një kornizë pune të qëndrueshme në kuadër të Rregullave Implementuese të INSPIRE.
Edukimi	Mungesa e vetëdijes për informacionin gjeohapësinorë dhe pamjaftueshmërisë së aftësive për të menaxhuar dhe shfrytëzuar të dhënat gjeohapësinore brenda sektorit publik.	Një model të qëndrueshëm dhe të përdorur gjerësisht për informacion gjeohapësinorë përmes financimit, përdoruesit dhe komuniteteve ofruese
Qeverisja	Mungesa e një pikë të vetme për pronësi të pavarur	Një model të rishikuar dhe të modifikuar qeverisës që mbikëqyr zbatimin e Strategjisë dhe monitorimin e vazhdueshëm
Licencimi	Mospërputhjet në modelet e licencimit, e cila lejon kompleksitetin e panevojshëm dhe janë të vështira për përdoruesit për t'i administruar	Një rritje të konsiderueshme në përdorimin e informacionit gjeohapësinorë përmes rishikimit dhe thjeshtimit të licencimit të dataseteve thelbësore gjeohapësinore

Shtojca 4: Temat e Direktivës të BE-së INSPIRE dhe referencat thelbësore gjeografike

INSPIRE (infrastruktura për Informacion Hapësinorë në Evropë) është Direktivë e BE-së që përcakton kornizë të përgjithshme për një Infrastrukturë të Informacionit Hapësinorë (IIH) për qëllime të politikave mjedisore të komunitetit dhe politikave apo aktiviteteve të cilat mund të kenë ndikim në mjedis. Ka për qëllim të përmirësojë ndërveprimin, dhe qasjen në informacionit gjeohapësinorë në gjithë Bashkimin Evropian në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtarë, të lehtësojë përmirësime në shkëmbimin e informacionit gjeohapësinorë në mes të autoriteteve publike dhe të sigurojë qasje të përmirësuar në informata gjeohapësinore. Ndërsa, mjedisi është fusha primare e politikave që do të mbulohen, INSPIRE ka potencial të zgjerojë edhe fusha të tjera të politikave siç janë bujqësia dhe transporti.

Kusht paraprak i INSPIRE është që infrastruktura Hapësinore e të dhënave për Evropë të ndërtojë mbi infrastrukturën e themeluarë dhe të drejtuarë nga Shtetet Anëtare, të cilat vetë duhet të jenë të dizajnuara për të siguruar që:

- Të dhënat gjeohapësinore janë ruajtur, janë vënë në dispozicion dhe mirëmbahen në nivel më të mundshëm të përshtatshëm.
- Të dhënat gjeohapësinore të mund të kombinohen nga burime të ndryshme në të gjithë komunitetin në një mënyrë të qëndrueshme dhe të shkëmbehen në mes të disa përdoruesve dhe aplikacioneve.
- Të dhënat e grumbulluara gjeohapësinore në nivel të autoritetit publik të mund të ndahen mes autoriteteve të tjera publike.
- Të dhënat gjeohapësinore janë vënë në dispozicion sipas kushteve të cilat nuk e kufizojnë padrejtësisht përdorimin e tyre të gjerë.
- Është e lehtë për të zbuluar të dhëna të disponueshme, për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre për qëllim dhe për të ditur kushtet e zbatueshme për përdorimin e tyre

Të dhënat gjeohapësinore të mbajtura nga një autoritet publik që janë të lidhura me një ose më shumë nga temat e listuara në tre shtojcat e prioritetëve mbulohen nga Direktiva dhe legjislacioni si motër, në formën e Rregullave të Zbatimit. Këto Rregulla të Zbatimit të cilat janë ligjërisht detyruese si Vendimet e BE-së, mbulojnë fushat kryesore të:

- Metadatave
- Ndërveprimin të dataseteve hapësinore
- Shërbimeve të rrjetit
- Të dhënave dhe Shkëmbimit të të Dhënave
- Monitorimit, raportimit dhe koordinimit

Edhe pse Rregullat e Zbatimit i mbulojnë kushtet e qasjes në të dhënat gjeohapësinore nga institucionet e komunitetit dhe organet, ndarja e të dhënave në kuadër të një Shteti Anëtarë është mbuluar nga vetë Direktiva vetë dhe nuk është temë e Rregullave të Zbatimit.

Direktiva, që siguron kornizën e punës dhe politikën, hyri në fuqi më 15 maj të vitit 2007. Secili Shtet Anëtarë duhej të transpozojë Direktivën në ligjin kombëtar. Rregullat e Zbatimit, të cilat ofrojnë shumë detaje teknike, janë të zhvilluara të gjitha, duke u pajtuar që të zhvillohen në faza deri në vitin 2020. Vetë rregullat janë kryesisht temë e shqyrtimit të Parlamentit Evropian para miratimit të Komitetit rregullativ të Vendeve Anëtare (të kryesuar nga Komisioni).

Temat INSPIRE – të mbuluara nga Direktivat dhe Rregullat Implementuese

Shtojca I

1. Sistemi referent për koordinatat
2. Sistemet e rrjetit gjeografik
3. Emrat gjeografik
4. Njësitë administrative
5. Adresat
6. Parcelat Kadastrale
7. Rrjetet e transportit
8. Rrjetet Hidrografike
9. Vendet e mbrojtura

Shtojca II

1. Lartësia (Elevimi)
2. Shtresa e tokës
3. Orto imazhet
4. Gjeologia

Shtojca III


1. Njësitë statistike
2. Ndërtesat
3. Dheu
4. Përdorimi i tokës
5. Shëndeti i njeriut dhe siguria
6. Përçojat dhe shërbimet qeveritare
7. Objektet për monitorimin e mjedisit
8. Objektet prodhuese dhe industriale
9. Objektet bujqësore dhe të kulturave ujore
10. Shpërndarja e popullsisë - demografia
11. Menaxhimi i zonës/ kufizimet/zonat e rregulloreve dhe njësitë raportuese
12. Zonat neutral të rrezikut
13. Kushtet atmosferike
14. Tiparet gjeografike meteorologjike
15. Tiparet gjeografike oqeano-grafike
16. Rajonet e detare
17. Rajonet bio-gjeografike
18. Habitatet dhe biotopet
19. Shpërndarja e specieve
20. Burimet e energjisë
21. Burimet minerale

Tërësia e *Referencave Thelbësore Gjeografike* të rekomanduara për tu zbatuar nga Strategjia për Zhvillimin e Infrastrukturës Kombëtare për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës është siç vijon:

- Korniza e Punës Gjeodezike
- Harta Topografike (në përpjesë duke përfshirë informacionin mbi lartësinë e tokës)
- Emrat gjeografikë
- Adresat
- Rrugët
- Pronësina e Pronës dhe Tokës
- Hidrologjia/Hidrografia
- Njësitë Statistikore
- Kufijtë Administrativë

Këto mund të zgjerohen që përfundimisht të përfshihet fushëveprimi i temave të Direktivës të BE-së INSPIRE, si dhe (draft ligjit) 'Ligji për themelimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Republikën e Kosovës '.

Shtojca 5: Struktura qeverisëse e propozuar për Zhvillimin e Strategjisë të Infrastrukturës Kombëtare për Informacion Hapësinorë të Kosovës



Akronimet e përdorura në këtë figurë

AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
IKIH	Infrastruktura Kombëtare për Informacion Hapësinorë
MP	Marrëdhënie me Publikun
GP	Grupet Punuese
Kom	Komunikimet

Shtojca 6: Vlerësimi i kostos për implementimin e IKIH-së

Tabela e përmbledhjes së vlerësimit të kostos për implementimin e IKIH-së i klasifikuar në trembëdhjetë kategori të aktiviteteve. Për më shumë detaje, vizitoni <http://www.kca-ks.org/>.

Aktiviteti	Përcaktimi i kostos për vetëm një herë (në Euro)	Kostot e vazhdueshme për tërë vitin (në Euro)
1. METADATA	11,800	4200
2. TË DHËNAT	231,000	7200
3. SHËRBIMET	87,000	54,200
4. TEKNOLOGJIA INFORMATIVE	760,000	235,000
5. STANDARIZIMI	5000	1800
6. QEVERISJA		74,600
7. SHKËMBIMI I TË DHËNAVE	25,000	5000
8. NDËRTINI I KAPACITETEVE	15,000	10,000
9. ZBATIMET	106,800	
10. PËRHAPJA	5700	10,700
11. MENAXHIMI I PERFORMANCËS	2400	1200
12. HULUMTIMI		25,000
13. TË PAPARASHIKUESHME	50,300	21,100
TOTAL	1,300,000	450,000

* Për të përmbushur këtë aktivitet në mënyrë të suksesshme nevojitet ekspertizë ndërkombëtare – supozohet që projekti ndërkombëtarë IMPULS 'Bashkëpunimi në rajonin e Ballkanit Përëndimorë' do ta ofrojë këtë ekspertizë ¹

** Vlerësimet e përafërta të shpenzimeve

¹ http://geospatialworldforum.org/workshop.asp?Sp_Department=IMPULS

Shtojca 7: Lista e akronimeve

Akronimet	Domethënia
BE	Bashkimi Evropian
SIG	Sistemet e Informacionit Gjeografikë
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
INSPIRE	Infrastruktura për Informacion Hapësinorë Evropë
SI	Sistemi Informativ
TI	Teknologji Informative
ONS	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë
IKIH	Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Hapësinorë
KHG	Konsortiumi i Hapur GjeoHapësinorë
MP	Marrëdhëniet me Publikun
H&ZH	Hulumtim dhe Zhvillim
IIH	Infrastruktura për Informacion Hapësinorë
GP	Grupi Punues

Shtojca 8: Fjalori i termeve

Terminologjia	Përkufizimi
Komitologjia	Sistemi i komiteteve që përdor Bashkimi Evropian për të vënë detaje ligjrisht të detyrueshme në legjislacionin kornizë
Gjeoportali	Faqe interneti, ose ekuivalente, që siguron qasje në shërbime
Informacion Gjeohapësinorë	Merren në kuptimin e saj më të gjerë që do të thotë informacion i gjeo-referuar për tokë, ujë dhe ajër
INSPIRE	Direktivë Evropiane e cili përcakton rregullat e përgjithshme që synojnë krijimin e Infrastrukturës për Informacion Hapësinorë në Komunitetin Evropian, për qëllime të politikave mjedisore të Komunitetit dhe politika apo aktivitete të cilat mund të kenë ndikim në mjedis
Ndërveprimi (Informacioni)	Aftësia për t'i referencuar objektet nga një dataset te objektet në datasetet e tjera ndërmjet një sistemi të përbashkët të gjeoreferencimit që inkorporon identifikues të përbashkët
Ndërveprimi (Sistemi)	Aftësia për të komunikuar, ekzekutuar programe ose për të transferuar të dhëna ndërmjet njësive të ndryshme funksionale në mënyrë që kërkon përdoruesin të ketë sado pak njohuri të karakteristikave unike të këtyre njësive
Teknologjia e Informacionit & Komunikimit	Studimi, projektimi, zhvillimi, zbatimi, mbështetja apo menaxhimi i sistemeve të informacionit të bazuar në kompjuter
Metadata	Të dhëna mbi të dhënat për të mbështetur zbulimin, eksplorimin dhe shfrytëzimin e informacionit dhe shërbimeve gjeohapësinore
KHG	Konsensusi ndërkombëtarë - organ i bazuar në standarde, jo-fitimprurës udhëheq zhvillimin e specifikimeve të hapura për qasje në informata gjeohapësinore në ueb
Të Dhënat gjeohapësinore	Çdo e dhënë me një referencë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në një vend të veçantë ose zonë gjeografike
Tërësia e të Dhënave Gjeohapësinore	Një koleksion i identifikueshëm i të dhënave gjeohapësinore
Infrastruktura e Informacionit Hapësinorë	Infrastruktura e cila lehtëson metadatat, tërësinë e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e informacioneve gjeohapësinore; shërbimet e rrjetit dhe teknologjisë; marrëveshje mbi ndarjen, qasjen dhe përdorimin; si dhe koordinimin dhe mekanizmat monitorues, proceset dhe procedurat
Shërbimet e Informacionit Gjeohapësinorë	Veprimet të cilat mund të kryhen, duke përdorur një aplikacion në kompjuter në të dhënat gjeohapësinore të përfshira në tërësinë e të dhënave gjeohapësinore ose në metadatat e ndërlidhura